

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“CAPITEVO GROUP” SHPK

ORTAKU I VETEM THEMELUES I SHOQERISE

Z.Edlir Fusha lindur ne Corodove,me 18.12.1986,banues ne Tirane,shtetas shqipetar,identifikuar me Leternjoftimin elektronik me numer 028049421,madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Mbeshtetur ne Ligjin nr.9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” dhe Ligjin Nr.9723 date 3.5.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit” dhe ne Legjislacionin shqiptar ne pergjithesi,person i mesiperm eshte Ortaku i Vetem si me poshte:

Emerimi,Selia dhe afati i shoqerise

Neni 1

Shoqeria eshte person juridik Shqiptar,veprimtaria e se ciles rregullohet nga kjo kontrate,Statuti i saj dhe Legjislacioni ne fuqi.

Neni 2

Shoqeria eshte emertuar “CAPITEVO GROUP” SHPK.

Neni 3

Shoqeria ka Seline e saj ne Bulevardin Zhan D'Ark, Ndertesa Nr.61, Hyrja Nr.3, Ap.11 Tirane, Shqiperi.

Neni 4

Shoqeria do te zhvilloj aktivitetin e saj me afat te pakufizuar.Ky afat mund te shkurtohet me vendim te Ortakut te Vetem.

Shoqeria “CAPITEVO GROUP” SHPK gezon statusin e personit juridik shqiptar nga momenti regjistrimit si e tille ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Neni 5

Shoqeria “CAPITEVO GROUP” SHPK zhvillon aktivitetin e saj si me poshte :

Sherbime Call Center dhe Contact Center per kliente jashte territorit te Republikes se Shqiperise. Sherbime marketingu jashte territorit te Republikes se Shqiperise nepermjet telefonit dhe internetit;

Projektimi dhe realizim i fushatave publicitare dhe promovuese nepermjet shfrytezimit te te



gjitha instrumentave,perfshire marketingun telefonik dhe instrumenta te tjera te marketingut nepermjet internetit per tu shitur ekskluzivisht jashte territorit te Republikes se Shqiperise. Dhenie ambjentesh me qira.

Neni 6

Shoqeria ushtron aktivitetin e saj ne Shqiperi dhe/ose jashte saj.

Neni 7

Selia e shoqerise mund te transferohet.

Neni 8

Kur shoqeria pushon veprimtarine e saj, pasi shlyen te gjitha detyrimet qe ka, pjesen e mbetur te kapitalit dhe te te ardhurave e perfiton ortakut i shoqerise.

Ortakut themelues perballon humbjet e shoqerise deri ne kufirin e vleres se tyre te derdhur ne formimin e kapitalit themeltar. Kapitulli baze mund te rritet nga fitimi,ne natyre,ose kredi ne leke ose valute qe merret ne Banke si dhe me kapitale te derdhura nga vete ortakut.

Kapitali i Shoqerise eshte ne shumen 10,000 (dhjete mije) Lek, e perbere nga ortakut i Vetem Themelues,Z.Edlir Fusha, 1 (nje) kuote me vlere 10,000 (dhjete mije) Lek.

Fitimet qe do te rezultojne pas miratimit te bilancit vjetor nga Ortaku i Vetem pas zbritjes se taksave do te ndahen si vijon:

- Fondi rezerve.
- Shperblimi qe i takon Ortakut themelues.

Neni 9

Shoqeria mund te hyje ne veprimtari te perbashketa me shoqeri te tjera shqiptare ose te huaja edhe kur ato nuk kane objekt aktiviteti ate te shoqerise.

Neni10

Veprimtaria e shoqerise mund te ushtrohet duke krijuar filiale ose perfaqesi brenda dhe jashte vendit,ne konformitet me ligjin shqiptar ose te huaj.

Administrimi

Organi vendimor i shoqerise eshte Ortaku i Vetem.

Neni 11

Administratori/Administratores

Ne shoqerine **Capitevo Group Shpk** administratori i shoqerise do te jete Z.Edlir Fusha,lindur ne Corodove,me 18.12.1986,madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Administratori emerohet per nje kohezgjatje prej pese vjetesh financiare.Administratori ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet me intere te shoqerise dhe ne emer te saj nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e veprimtarise se shoqerise me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji nuk i njej.Administratori ndryshohet me vendim te Ortakut te Vetem.

Mbyllja e Shoqerise

Neni 12

Veprimtaria e shoqerise pushon me propozimin e bere nga Ortaku i Vetem, kur gjate dy vjeteve nuk rezulton rentabel si dhe ne te gjitha rastet qe parashikohen ne dokumentet e krijimit te shoqerise. Shoqeria shperndahet ne forme riorganizimi ose likujdimi.

Kur shoqeria likujdohet:

Neni 13

Ortaku i Vetem emeron likujdatorin dhe shoqeria i jep fund veprimtarise se saj ne castin e miratimit te ketij bilanci te likujdimit. Komisionii Likujdimit perbehet nga nje ose tre antare. Pasurite qe jane vene ne dispozicion te shoqerise me te drejte shfrytezimi, shiten ne varesi te shkalles se konsumit te tyre. Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se shoqerise e te filialeve te saj dhe fondet financiare i kalojne Ortakut, pasi te jene bere pagesat per kreditorët.

Neni 14

Kur pushon veprimtaria e nje filiali, per efekte te riorganizimit te tij, afatet e pushimit caktohen nga ortaku i Vetem. Likujdimi i filialeve behet njelloj si per shoqerine.

Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se filialit te likujduar dhe fondet e tij financiare vihen ne dispozicion te shoqerise pasi tu jene bere pagesat likujdatoreve.

Dispozita te hollesishme mbi organizimin e kesaj shoqerie percaktohen ne statutin e saj.

DT: 14-10-2021

CAPITEVO GROUP SHPK

ORTAKU I VETEM THEMELUES

Edlis Fusha

EDLIR FUSHA

